



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE**

M A T U R A S H T E T Ë R O R E 2 0 1 5

**RAPORT PUBLIK
M B I
A R R I T J E T E N X Ë N Ë S V E**

TIRANË, Dhjetor 2015

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	4
<i>Metodologjia</i>	4
I Lënda: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe	6
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	6
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe</i>	16
3 <i>Arritjet e nxënësve në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe - statistika krahasuese</i>	18
II Lënda: Matematikë	24
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	24
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës</i>	34
3 <i>Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese</i>	36
III Lënda: Gjuhë e Huaj	42
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	42
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj</i>	51
3 <i>Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese</i>	52
IV Lëndët me Zgjedhje	58
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	58
2 <i>Statistika përmbledhëse për MSH2015</i>	87

Hyrje

Ndryshimet strukturore dhe përmbajtësore që ka pësuar sistemi ynë arsimor gjatë dy dekadave të fundit kanë bërë të mundur që çdo fëmijë të ketë mundësinë për të marrë aftësitë e nevojshme që do t'i duhet për t'u përfshirë në botën e punës, si dhe për jetën në përgjithësi.

Cilësia dhe vitet e shkollimit të një nxënësi/fëmije ndikojnë fuqimisht në perspektivën shoqërore dhe ekonomike të vetë fëmijës/nxënësit, si edhe të shoqërisë sonë në tërësi. Rrjedhimisht, është thelbësore që çdo fëmijë/nxënësi të ketë jo vetëm akses, por edhe të përfundojë një arsim cilësor prej të paktën 12 vjetësh.

Parë në këtë këndvështrim, ky raport synon dhënien e një informacioni mbi arritjet e nxënësve të Maturës Shtetërore 2015 në përfundim të 12 viteve shkollimi. Prej vitesh, procesi i Maturës Shtetërore ka treguar se është një vlerësim i jashtëm i arritjeve të nxënësve, që është i realizuar sipas procedurave vlerësuese standarde.

Informacioni i dhënë në këtë material synon të paraqesë nivelin aktual të arritjeve të nxënësve në lëndët e testuara në Maturën Shtetërore 2015, duke u ardhur në ndihmë politikë-bërësve dhe vendim-marrësve të sistemit arsimor për të hartuar politika të reja bazuar në evidenca. Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që bën të mundur jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel DAR/ZA, por njëkohësisht edhe krahasimin mes DAR/ZA, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e të dhënave të krijuar nga AKP për realizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2015. Baza e të dhënave është plotësuar nga notat vjetore të çdo nxënësi për lëndët letërsi dhe gjuhë shqipe, matematikë, lënda gjuhë e huaj, si dhe lëndët me zgjedhje.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave të AKP janë:

- numri identifikues i nxënësit (ID),
- gjinia e nxënësit,
- DAR apo ZA (së cilës i përket shkolla që ka frekuentuar nxënësi),
- lloji i shkollës (publike/private),
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet),
- profili i studimeve që ka ndjekur nxënësi,
- viti kur nxënësi ka mbaruar studimet e shkollës mesme,
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor,
- lloji i testit të provimit të maturës,
- pikët e fituara në test nga nxënësit,
- nota në provimin e maturës,
- nota vjetore.

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve janë paraqitur:

- në nivel kombëtar,
- sipas urbanizimit – fshat/qytet,
- sipas gjinisë - femra/meshkuj.

Në përpunimin statistikor të të dhënave janë përfshinë **vetëm** të dhënat e arritjeve të nxënësve maturan të vitit shkollor 2014-2015, të cilët morën pjesë në provimet e MSH 2015, sesioni i qershorit. Numri i nxënësve sipas lëndëve dhe kategorive publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përdorur për këtë raport, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim		
		Total	Publik	Privat			Total	Publik	Privat
1	Letërsi	38382	33516	4866	1	Letërsi	38382	33516	4866
	Qytet	29126	24393	4733		Femra	20618	18062	2556
	Fshat	9256	9123	133		Meshkuj	17764	15454	2310
2	Matematikë	38360	33505	4855	2	Matematikë	38360	33505	4855
	Qytet	29108	24386	4722		Femra	20608	18058	2550
	Fshat	9252	9119	133		Meshkuj	17752	15447	2305
3	Gjuhë e Huaj	38887	34037	4850	3	Gjuhë e Huaj	38887	34037	4850
	Qytet	29516	24799	4717		Femra	20662	18119	2543
	Fshat	9371	9238	133		Meshkuj	18225	15918	2307

Përpunimi statistikor i të dhënave u realizua nëpërmjet software -ve SPSS and Statistika.


Të dhënat e përfituara nga përpunimi statistikor janë përdorur për të organizuar informacionin në formën tabelare apo grafike. Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim,
- Nota mesatare Vjetore - (NV),
- Nota mesatare e Maturës - (NM),
- Shmangia standarde – (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*),
- Nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk),
- Nota mesatare e Maturës në nivel kombëtar - (NMk),
- Kalueshmëria në provimin e Maturës,
- Diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën e Maturës në nivel kombëtar - (NM – NMk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën Vjetore - (NM – NV).

Lënda: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

1) Arritjet e Nxënësve

Figura e mëposhtme jep arritjet e nxënësve në provimin e maturës dhe arritjet vjetore në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar (republika) dhe në nivel DAR/ZA. Në figurë jepet informacion mbi përqindjen e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen



në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”. Niveli mesatar është konsideruar kufiri mes notës **shtatë dhe tetë**. Në arritjet e maturës, në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-nën nivelin mesatar” është 66.5%, kundrejt 62.1% në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-mbi nivelin mesatar” është 33.5% për arritjet në provimin e maturës, kundrejt 37.9% në arritjet vjetore. Diferenca prej 4.4% është një tregues i arritjeve mesatare të qëndrueshme të nxënësve në nivel kombëtar. Figura tregon se, **DAR/ZA: Vlora, Tropoja, Tepelena, Mallakastër, Malësi e Madhe, Lushnjë, Has, Gjirokastrë, Delvinë, kanë diferenca të theksuara mes arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e maturës.**

Më poshtë, në Tabelën L – 1 është dhënë informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë në nivel kombëtar, sipas urbanizimit **fshat/qytet**, sipas gjinisë **femra/meshkuj**, dhe sipas sistemit **publik/privat** të edukimit. Në nivel kombëtar, mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë është 24.88 pikë, me shmangie mesatare 9.03, nota mesatare e maturës është 6.78 me shmangie mesatare 1.25, ndërsa nota mesatare vjetore është 6.88 me shmangie mesatare 1.72. Në nivel kombëtar nota mesatare e provimit të maturës (6.78) është 0.1 njësi note më e ulët kundrejt notës vjetore të nxënësve (6.88).

Krahasimi i arritjeve të nxënësve në nivel kombëtar për kategoritë e urbanizimit qytet/fshat tregon se, **arritjet e nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet janë më të larta kundrejt arritjeve të nxënësve që e kanë ndjekur shkollën në fshat**. Mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth 4.5 pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit. Kjo diferencë prej 4.5 pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive referuar notës mesatare të provimit të maturës, vlera e të cilës është me 0.84 njësi notë.

Në nivel kombëtar, referuar kategorisë së gjinisë, **diferencat më të mëdha ekzistojnë mes djemve që kanë ndjekur shkollën në qytet me djemtë që e kanë ndjekur shkollën në fshat**. Për të tre treguesit statistikorë të Tabelës L-1, shihet se **arritjet e djemve në qytet janë më të larta kundrejt djemve të fshatit**. Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, djemtë e qytetit kanë një notë mesatare me një vlerë prej 0.6 njësi note më të lartë se djemtë e fshatit. Nëse i referohemi arritjeve në provimin e maturës, diferenca shkon në 0.67 njësi notë. Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e maturës për djemtë e qytetit është **4.68 pikë** më e lartë kundrejt djemve të fshatit.


Nëse krahasojmë arritjet mesatare të vajzave të qytetit kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit, Tabela L-1 paraqet të njëjtën situatë si edhe për kategorinë e djemve, të analizuar më lart. Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e maturës për **vajzat e qytetit është 4.61 pikë më e lartë kundrejt vajzave të fshatit**. Të njëjtën situatë kemi edhe për notën mesatare vjetore dhe notën mesatare në provimin e maturës, ku vajzat e qytetit kanë një notë mesatare prej 0.6 njësi note më të lartë.

Nga të dhënat e Tabelës L-1 shohim se kemi diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve në të dy sistemet arsimore, publik e privat, që ekzistojnë në vendin tonë. Arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik. Kjo

I. Lënda: Matematikë

1) Arritjet e Nxënësve

Figura e mëposhtme jep arritjet e nxënësve në provimin e maturës dhe arritjet vjetore në lëndën e Matematikës. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar (republika) dhe në nivel DAR/ZA. Në figurë jepet informacion mbi përqindjen e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”. Niveli mesatar është marrë kufiri mes notës 7 e 8.



Në arritjet e maturës në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-nën nivelin mesatar” është 74.7% kundrejt 76.3% në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar - mbi nivelin mesatar” është 25.3% për arritjet në provimin e maturës kundrejt 23.7% në arritjet vjetore. Diferenca prej 1.6% është një tregues i arritjeve mesatare të qëndrueshme të nxënësve në nivel kombëtar. Figura tregon se, DAR/ZA Tirana Qark, Tepelena, Sarandë, Mallakastër, Kurbin, Kukës, Kavajë kanë diferenca të theksuara mes arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e maturës.

Tabela M-1 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, për sistemin publik e privat të edukimit.

Tabela M-1

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	24.47	12.66	6.66	1.76	6.65	1.73
	Meshkuj	19.42	11.08	5.94	1.57	5.74	1.48
	Total	22.14	12.22	6.33	1.71	6.23	1.69
Qytet	Femra	26.20	12.92	6.90	1.79	6.79	1.78
	Meshkuj	20.63	11.57	6.12	1.63	5.86	1.55
	Total	23.60	12.62	6.54	1.76	6.36	1.74
Fshat	Femra	19.18	10.10	5.92	1.45	6.25	1.52
	Meshkuj	15.54	8.18	5.39	1.19	5.37	1.15
	Total	17.53	9.46	5.68	1.36	5.85	1.43
Publik total	Femra	23.53	12.38	6.53	1.73	6.50	1.68
	Meshkuj	18.46	10.55	5.81	1.50	5.58	1.36
	Total	21.19	11.84	6.19	1.67	6.08	1.61
Qytet	Femra	25.27	12.78	6.77	1.77	6.61	1.73
	Meshkuj	19.57	11.11	5.97	1.57	5.67	1.42
	Total	22.63	12.37	6.40	1.73	6.17	1.66
Fshat	Femra	18.97	9.91	5.89	1.43	6.22	1.50
	Meshkuj	15.41	8.06	5.37	1.17	5.35	1.13
	Total	17.35	9.29	5.65	1.34	5.83	1.42
Privat total	Femra	31.16	12.57	7.59	1.70	7.74	1.73
	Meshkuj	25.90	12.34	6.87	1.70	6.85	1.79
	Total	28.66	12.74	7.25	1.74	7.32	1.82
Qytet	Femra	31.13	12.56	7.59	1.70	7.74	1.73
	Meshkuj	25.90	12.38	6.87	1.71	6.86	1.79
	Total	28.63	12.74	7.25	1.74	7.32	1.81
Fshat	Femra	31.96	12.95	7.70	1.75	7.71	1.87
	Meshkuj	25.86	10.95	6.88	1.52	6.61	1.76
	Total	29.67	12.55	7.39	1.71	7.30	1.90

Bazuar në të dhënat e Tabelës M-1, në nivel kombëtar, mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Matematikës është 22.14 pikë, me shmangie mesatare 12.22, nota mesatare e maturës 6.33 me shmangie mesatare 1.71, dhe nota mesatare vjetore 6.23 me shmangie mesatare prej 1.69. Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të maturës, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se ndryshueshmëria është me 0.1 njësi notë.

Të dhënat e Tabelës M-1 tregojnë se, në provimin e maturës, arritjet mesatare për vajzat janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve. Në nivel kombëtar, mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth 5 pikë mbi nivelin e pikëve mesatare të fituara nga djemtë.

Nëse krahasojmë rritjen e notës mesatare të maturës kundrejt notës mesatare vjetore, në nivel kombëtar, për vajzat kjo rritje rezulton minimale, afërsisht 0.01 njësi note (6.66 nota mesatare e maturës; 6.65 nota mesatare vjetore), ndërsa për djemtë është 0.2 njësi note (5.94 nota mesatare e maturës; 5.74 nota mesatare vjetore).

Nëse i referohemi sistemit privat, si për kategorinë privat total, po ashtu edhe për kategoritë fshat/qytet, shohim se vajzat kanë arritje më të ulta në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore. Ndërsa, djemtë në sistemin privat, si edhe për kategoritë fshat/qytet kanë arritje më të larta në provimin e maturës referuar arritjeve vjetore.

Për nivelin kombëtar, arritjet e nxënësve sipas kategorive të urbanizimit fshat/qytet, tregojnë se kemi diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë rreth 6 pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit, ndërkohë kur vlerat e shmangies mesatare për pikët e fituara në test për të dyja kategoritë, janë 12.62 për qytetin dhe 9.46 për fshatin.

Në sistemin privat, arritjet e mesatare në provimin e maturës për kategorinë fshat janë më të larta referuar arritjeve të nxënësve për kategorinë qytet. Mesatarja e pikëve të nxënësve të fshatit, në sistemin privat është 29.67 pikë kundrejt 28.63 pikë të nxënësve të qytetit.

Nga Tabela M-1, rezulton se, arritjet mesatare të nxënësve në provimin e maturës, për kategoritë qytet/fshat, publik/privat janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare vjetore respektive të këtyre kategorive. Përrjashtim bëjnë kategoria e vajzave të sistemit privat ku arritjet vjetore janë më të larta se arritjet në provimin e maturës.


Diferenca prej 7.5 pikësh e mesatares së pikëve mes sistemit privat me atë publik, tregojnë se, edhe për lëndën e matematikës, ekzistojnë diferenca të mëdha mes dy sistemeve arsimore që ekzistojnë në vendin tonë. Nga të dhënat e Tabelës M-1, rezulton se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të maturës dhe atë vjetore.

Analiza e qëndrueshmërisë së arritjeve të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, tregon se, për lëndën e matematikës, nxënësit e sistemit publik dhe nxënësit e sistemit privat kanë nivele të njëjta të qëndrueshmërisë së arritjeve. Kjo situatë është e vlefshme për të gjitha kategoritë, femra/meshkuj dhe qytet/fshat.

II. Lënda: Gjuhë e Huaj

1) Arritjet e Nxënësve

Figura e mëposhtme jep arritjet e nxënësve në provimin e maturës dhe arritjet vjetore në lëndën e Gjuhës së Huaj. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar (republika) dhe në nivel DAR/ZA. Në figurë jepet informacion mbi përqindjen e nxënësve, njohuritë e të cilëve janë në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”. Niveli mesatar është marrë kufiri mes notës 7 e 8.



III. Lëndët me Zgjedhje

Arritjet e Nxënësve

Informacion mbi arritjet e nxënësve në lëndët me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2015 paraqiten në tabelat që pasojnë. Në këtë material janë përlogaritur arritjet mesatare të nxënësve për lëndët me zgjedhje, të cilat janë dhënë provim nga një numër i konsiderueshëm nxënësish. Tabela Z-1 paraqet listën e lëndëve me zgjedhje, numrin përkatës të nxënësve të testuar në çdo lëndë me zgjedhje, si dhe kalueshmërinë përkatëse.

Niveli i kalueshmërisë në këto lëndë me zgjedhje është përgjithësisht i lartë, Kujtojmë se pikët maksimale të çdo testi të Lëndëve me Zgjedhje janë 40 pikë.

Pothuajse në të gjitha lëndët me zgjedhje:

- Nxënësit e qytetit kanë arritje më të larta referuar nxënësve të fshatit;
- Nxënësit e sistemit privat kanë arritje më të larta referuar nxënësve të sistemit publik,
- Vajzat (në përgjithësi) kanë arritje më të larta se djemtë, kjo si rrjedhojë e mënyrës sistematike të të mësuarit nga ana e tyre, si dhe ndikimit të faktorëve të fuqishëm motivues për vazhdimin e studimeve të larta universitare, që sigurojnë më shumë mundësi për punësim.

Tabela Z-1

Nr.	Lënda e Provimit me zgjedhje	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim (në %)
		Total	Publik	Privat	
1	Qytetari	22941	21170	1771	95.6%
2	Sociologji	1343	1100	243	90.3%
3	Ekonomi bërthamë	2384	1856	528	92.5%
4	Ekonomi e thelluar	1487	1178	309	96.4%
5	Kimi bërthamë	601	497	104	94.0%
6	Gjeografi bërthamë	7135	6904	231	95.3%
7	Fizikë bërthamë	631	521	110	97.5%
8	Histori bërthamë	4686	4376	310	84.9%
9	Letërsi e thelluar	5337	4950	387	87.4%
10	Matematikë e thelluar	4401	3425	976	99.5%
11	Biologji bërthamë	1686	1459	227	94.6%
12	Biologji e thelluar	2591	2038	553	96.2%
13	Anglisht	11683	9189	2494	99.5%
14	Lëndë Profesionale	3593	3225	368	90.4%

Informacioni i paraqitur për lëndët me zgjedhje përmban këta tregues:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim;
- Nota mesatare e Maturës (NM);
- Nota mesatare Vjetore (NV);
- Shmangia standarde - *shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*

RAPORT PUBLIK

36	Tirane Qark	100.00%	25.43	7.95	7.41	1.52	9.78	0.25
37	Tropoje	100.00%	22.33	7.23	6.83	1.33	8.73	0.75
38	Vlore	82.79%	14.00	8.35	5.48	1.35	6.07	1.07

Statistika përmbledhëse për MSH2015

Nr.	Lënda e Provimit me zgjedhje	Numri i nxenesve që moren pjesë në provim			Kalueshmëria në provim (në %)	Nota mesatare në provimin e Maturës	Nota mesatare e Vjetore
		Total	Publik	Privat			
Sesioni i Qershorit							
1	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	38382	33516	4866	96.42%	6.78	6.88
2	Matematikë	38360	33505	4855	91.75%	6.33	6.23
3	Gjuhë e Huaj	38887	34037	4850	99.38%	7.79	6.79
4	Lëndë me Zgjedhje	70499	61888	8611	98.70%	6.57	7.30
Të gjitha lëndët		186128	162946	23182	95.40%	6.82	6.88
Sesioni i Qershorit dhe Vjeshta							
1	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	39910	35015	4895	97.25%	6.71	6.83
2	Matematikë	39896	35000	4896	93.60%	6.29	6.20
3	Gjuhë e Huaj	38887	34037	4850	99.38%	7.79	6.79
4	Lëndë me Zgjedhje	79657	69896	9761	96.91%	6.56	7.44
Të gjitha lëndët		198350	173948	24402	96.80%	6.78	6.93